



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1467 Prot.

Tiranë, më 22.04.2026

VENDIM

Nr. 2, Datë 22.04.2026

**PËR SHPALLJEN E NJË VENDI VAKANT PËR ANËTAR TË KËSHILLIT TË LARTË  
TË PROKURORISË NGA TRUPA E PEDAGOGËVE TË FAKULTETEVE TË  
DREJTËSISË DHE SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS**

Në mbështetje të neneve 134 dhe 135 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 11 dhe 16 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

**V E N D O S A:**

1. Shpalljen e një vendi vakant për anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të Drejtësisë dhe Shkolla e Magjistraturës.
2. Shërbimet e Kuvendit të bëjnë shpalljen dhe publikimin e vakancës në faqen zyrtare dhe rrjetet sociale zyrtare të Kuvendit. Në shpallje të përfshihen kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët sipas neneve 134 dhe 137 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Genci GJONCAJ